Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

2017/II

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 270 kopje
Shtypur nga *sh.p.k.*

P Ë R M B A J T J A

OBJEKTIVI 7

FJALA E GUVERNATORIT 9

1. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË 12

2. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË 15

2.1. Ekonomia botërore 15
2.2. Ecuria e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet botërore 19
2.3. Tregjet financiare 20

3. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE 22

3.1. Zhvillimet në tregjet financiare 22
3.2. Normat e interesit të depozitave dhe kredive dhe kushtet e financimit 25
3.3. Kreditimi i sektorit privat 27
3.4. Financimi i sektorit publik 29
3.5. Ecuria e depozitave dhe e parasë në ekonomi 30

4. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE 32

4.1. Ecuria e inflacionit 32
4.2. Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate 36
4.3. Gjendja ciklike e ekonomisë dhe presionet e brendshme inflacioniste 49
4.4. Inflacioni i importuar 52
4.5. Pritjet për inflacionin 53

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1: Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit kundrejt indeksit të çmimeve të konsumit: dy tregues të ndryshëm 34
Hapësirë informuese 2: Zhvillimet në bilancin e pagesave në tremujorin e katërt të vitit 2016 48

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2. Ambienti i jashtëm i ekonomisë
Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë 16
Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet fqinje 18

4. Inflacioni dhe rritja ekonomike
Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor 33
Tabelë 4. Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor për tremujorin e parë të 2017 sipas IÇK-së dhe IHÇK-së 35
Tabelë 5. Tregues të bilancit të pagesave 48

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

1. Stabiliteti i çmimeve dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë

Grafik 1. Normat e interesit në monedhën vendase 13
Grafik 2. Treguesi i përbërë paraprijës i PBB-së (CLI) dhe Prodhimi Industrial i vendeve kryesore dhe inflacioni 15

2. Ambienti i jashtëm i ekonomisë

Grafik 3. Indeksi i përbërë i prodhimit (PMI), PBB-ja tremujore dhe treguesi i ndjesisë ekonomike dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin dhe konsumatorët 17
Grafik 4. Ndryshimet vjetore të çmimeve të mallrave bazë 19
Grafik 5. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore 20
Grafik 6. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 20
Grafik 7. Operacionet e tregut të hapur të BSh dhe normat e interesit në tregun ndërbankar 22

3. Tregjet financiare dhe zhvillimet monetare

Grafik 8. Ecuria e kursit të këmbimit 23
Grafik 9. Yield-et në tregun primar 24
Grafik 10. Normat e interesit për depozitat e reja me afat 25
Grafik 11. Normat e interesit për kredinë e re, mesatare rrëshqitëse 6-mujore 26
Grafik 12. Kushtet e kreditimit (për biznese majtas, për individë djathtas) 27
Grafik 13. Kredia për sektorin privat sipas monedhës dhe agjentëve ekonomikë 28
Grafik 14. Ecuria e kredisë sipas agjentëve ekonomikë 29
Grafik 15. Deficiti buxhetor dhe instrumentet e financimit të tij 29
Grafik 16. Ecuria e treguesve monetarë 30
Grafik 17. Ecuria e depozitave në sistemin bankar 31
Grafik 18. Inflacioni vjetor dhe objektivi. Inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE 32

4. Inflacioni dhe rritja ekonomike

Grafik 19. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total 33
Grafik 20. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit 37
Grafik 21. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve 38
Grafik 22. Ecuria e vlerës së shtuar në ndërtim dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve 38
Grafik 23. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve 39
Grafik 24. Treguesi i ndjesisë ekonomike dhe struktura e kërkesës së brendshme 41
Grafik 25. Ecuria e konsumit privat 41
Grafik 26. Tregues të tërthortë sasiorë dhe cilësorë për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e parë 42
Grafik 27. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore 42
Grafik 28. Tregues afatshkurtër të investimeve për tremujorin e parë 43
Grafik 29. Indeksi i çmimit dhe i qirasë së banesave dhe raporti i tyre 43
Grafik 30. Orientimi i politikës fiskale 44
Grafik 31. Ecuria e shpenzimeve 45
Grafik 32. Ecuria e të ardhurave buxhetore 45
Grafik 33. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate 46
Grafik 34. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive 46
Grafik 35. Ecuria vjetore e çmimit të naftës në tregun Brent, e eksportit të naftës vendase, e indeksit të çmimit të metaleve dhe e eksportit të metaleve vendase 47
Grafik 36. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë 50
Grafik 37. Ndryshimet vjetore mesatare të sheshuara të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit 51
Grafik 38. Prirjet afatgjata të inflacionit dhe prirjet afatshkurtra 51
Grafik 39. Kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor TPHI dhe kontributet e përbërësve të tij 52
Grafik 40. Pritjet inflacioniste të bizneseve dhe të konsumatorëve dhe të agjentëve financiarë 53

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nxitja e investimeve afatgjata, ruajtja e fuqisë blerëse të parasë, rritja e eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetja e stabilitetit financiar, janë disa nga përfitimet e një mjedisi ekonomik të karakterizuar nga stabiliteti i çmimeve. Ky stabilitet është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në përputhje me strategjinë e miratuar në Dokumentin e Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0% në një periudhë afatmesme. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut.

Në përmbushje të këtij qëllimi dhe për të forcuar transparencën e saj, Banka e Shqipërisë përgatit dhe publikon çdo tre muaj Raportin e Politikës Monetare. Ky Raport është instrumenti kryesor i komunikimit të politikës monetare me publikun. Ai paraqet një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Raporti tremujor i politikës monetare 2017/II, u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.23, datë 03.05.2017. Analiza ekonomike, financiare dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat më të fundit në dispozicion, deri më 20 prill 2017.

FJALA E GUVERNATORIT

Informacioni i analizuar në këtë raport ka rezultuar përgjithësisht në linjë me pritjet e Bankës së Shqipërisë. Të dhënat e reja ekonomike dhe financiare tregojnë një përshpejtim të rritjes ekonomike dhe një përmirësim të balancave kryesore makroekonomike gjatë fundit të vitit 2016 dhe fillimit të vitit 2017.

Inflacioni erdhi në rritje në tremujorin e parë të vitit 2017, duke shënuar një vlerë mesatare prej 2.4%. Ecuria e inflacionit u përcaktua nga rritja e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës. Çmimet e artikujve të tjerë të shportës nuk pësuan ndryshime të ndjeshme, duke vazhduar të japin kontribute të ulëta pozitive.

Në këndvështrimin makroekonomik, prirja rritëse e inflacionit mbështetet nga përmirësimi i aktivitetit ekonomik dhe shfrytëzimi më i plotë i kapaciteteve prodhuese, nga tendencat rritëse të çmimeve në tregjet botërore, si dhe nga ankorimi më i mirë i pritjeve inflacioniste.

Efekti i këtyre faktorëve pritet të shtrihet edhe në periudhat në vijim. Inflacioni parashikohet të qëndrojë rreth nivelit mesatar prej 2.3% për vitin 2017 dhe të rritet më tej – drejt objektivit – gjatë vitit të ardhshëm.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ritmi i rritjes ekonomike u përmirësua në tremujorin e fundit të vitit të shkuar. Prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 4.0% në këtë tremujor, duke e çuar rritjen ekonomike të vitit 2016 në nivelin 3.5%. Kontributin më të madh në zgjerimin e aktivitetit ekonomik e dhanë sektori i shërbimeve dhe ai i ndërtimit, ndërkohë që sektori i industrisë dhe i bujqësisë patën rritje pozitive, por më të ulët.

Në terma të kërkesës agregate, rritja ekonomike pasqyroi zgjerimin e kërkesës së brendshme dhe të huaj për mallra e shërbime. Konsumi dhe investimet private janë rritur, të mbështetur nga normat e ulëta të interesit, nga zgjerimi i punësimit dhe përmirësimi i besimit, si dhe nga flukset e larta hyrëse të investimeve të huaja direkte. Paralelisht me to, rritja ekonomike e tremujorit të katërt përfitoi nga një aktivitet i shtuar turistik dhe nga rikuperimi i ritmeve rritëse të eksporteve të mallrave.

Të dhënat indirekte të disponuara sugjerojnë se këto tendenca kanë vazhduar edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2017.

Të dhënat fiskale të tremujorit të parë tregojnë një reduktim të shpejtësisë së konsolidimit fiskal, të materializuar në një suficit buxhetor 33.2% më të ulët se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shpenzimet buxhetore të këtij tremujori

njohën një rritje prej 10.3% në terma vjetorë, përkundrejt rritjes prej 4.3% që shënuan të ardhurat. Plani buxhetor i vitit 2017 sugjeron një kontribut të shtuar të politikës fiskale në rritjen e kërkesës agregate, por Banka e Shqipërisë vazhdon të tërheqë vëmendjen mbi nevojën për një shpërndarje më të njëtrajtshme të shpenzimeve dhe të deficitit buxhetor përgjatë vitit.

Analiza e informacionit të disponuar evidenton rolin pozitiv që ka pasur politika monetare. Tregjet financiare karakterizohen nga nivele të ulëta të normave të interesit të depozitave dhe të kredive. Rritja e *yield*-eve të letrave me vlerë të qeverisë në fund të vitit rezultoi e përkohshme dhe nuk u transmetua në segmentet e tjera të tregut financiar. Kushtet monetare stimuluese kanë favorizuar rritjen e kreditimit dhe uljen e kostos së shërbimit të borxhit; në këtë mënyrë, ato kanë mbështetur gjallërimin e konsumit dhe të investimeve private, si dhe kanë krijuar parakushtet e nevojshme për kthimin e inflacionit në objektiv.

Politika monetare ka mbështetur veçanërisht rritjen e kredisë në monedhën vendase, ndonëse rritja totale e kredisë mbetet ende e zbehtë. Në fund të muajit mars, kredia për sektorin privat ishte 3.3% më e lartë se një vit më parë. Gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, kredia në lekë shënoi një rritje prej 10.2%, ndërsa kredia në valutë një reduktim prej 1.5%. Në aspektin sektorial, zgjerimi i kredisë është i përqendruar tek segmenti i individëve, ndërkohë që kreditimi i bizneseve shfaqet i ngadaltë, i ndikuar si nga kërkesa e dobët e bizneseve, ashtu dhe nga oferta e shtrënguar e sektorit bankar.

Duke gjykuar mbi tendencat aktuale ekonomike dhe financiare, si dhe mbi faktorët mbështetës të tyre, Banka e Shqipërisë vlerëson se përmirësimi ciklik i ekonomisë do të vazhdojë edhe në periudhën afatmesme. Sipas skenarit bazë, në këtë horizont kohor ne presim një rritje të mëtejshme të aktivitetit ekonomik, të mbështetur nga gjallërimi i kërkesës së brendshme dhe nga përmirësimi i ambientit të huaj. Rritja e aktivitetit ekonomik pritet të shoqërohet me përthithjen e kapaciteteve të lira të prodhimit, si në tregjet e punës, dhe në ato të kapitalit. Kthimi i ekonomisë në ekuilibër do të krijojë premisat e duhura për kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv brenda vitit 2018.

Banka e Shqipërisë vlerëson se përmbushja e këtyre projeksioneve kërkon ruajtjen e miksit aktual të politikave makroekonomike dhe vazhdimin e reformave strukturore.

Politika fiskale pritet dhe duhet të vazhdojë të ruajë një natyrë konsoliduese në afatin e mesëm. Kjo politikë ul primet e rrezikut, rrit hapësirat për kreditimin e sektorit privat dhe forcon kapacitetin e vendit për përballimin e goditjeve në të ardhmen.

Duke u nisur nga informacioni i disponuar, politika monetare do të vazhdojë të mbetet në kahun lehtësues gjatë periudhës afatmesme. Kjo politikë siguron stimulin e nevojshëm për nxitjen e aktivitetit ekonomik dhe për kthimin e inflacionit në objektiv.

Në horizontin afatmesëm, Banka e Shqipërisë pret një përmirësim progresiv të kërkesës për kredi. Kjo kërkesë e shtuar duhet të gjejë një ofertë kredie të rritur. Në këtë drejtim, reduktimi në 17.4% i raportit të kredive me probleme në muajin mars është një zhvillim inkurajues, por ai duhet të shoqërohet nga vazhdimi i zbatimit të nismave të iniciuara për përmirësimin e mëtejshëm të ambientit të kredisë, si dhe nga politika më aktive të bankave drejt kredidhënies. Në këtë kontekst, është e nevojshme të vazhdohen reformat strukturore në drejtim të përmirësimit të klimës së biznesit, të rritjes së eficiencës dhe të zgjerimit të potencialit prodhues të vendit.

1. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë hartohet dhe zbatohet duke pasur si objektiv arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Për t'iu përgjigjur presioneve të ulëta inflacioniste të shkaktuara nga rritja e ngadaltë e ekonomisë pas krizës financiare, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese. Norma bazë e interesit është ulur gradualisht dhe qëndron në nivelin minimal historik prej 1.25%. Gjithashtu, komunikimi i politikës monetare ka synuar të sigurojë agjentët e tregut se normat e ulëta të interesit do të ruhen për disa periudha. Nëpërmjet këtyre instrumenteve, politika monetare stimuluese ka luajtur një rol parësor për nxitjen e kërkesës së brendshme private, për fuqizimin e rritjes ekonomike dhe për vendosjen e inflacionit në një trajektore konverguese drejt objektivit.

Ecuria e aktivitetit ekonomik është pozitive dhe pritjet tona janë për vijimin e kësaj tendence në afatin e mesëm. Stimuli monetar vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur rritjen e ekonomisë drejt ekuilibrit dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2018. Megjithatë, balanca e rreziqeve për materializimin e këtyre pritjeve është e zhvendosur poshtë. Nisur nga këto konsiderata, politika monetare do të vazhdojë të mbetet stimuluese, por intensiteti i stimulit monetar do të përshtatet me nevojat e ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë.

Zhvillimet ekonomike e financiare në vend janë pozitive dhe konfirmojnë trendin rritës të ekonomisë shqiptare. Statistikat e publikuara nga INSTAT-i evidentojnë përshpejtimin e aktivitetit ekonomik, zgjerimin e punësimit në tremujorin e fundit të vitit 2016, si dhe rritjen e inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2017. Inflacioni vjetor shënoi një normë mesatare prej 2.4% gjatë kësaj periudhe. Në aspektin e kompozimit, rritja e tij i atribuohet më së shumti rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe të naftës. Gjithashtu, ajo ka reflektuar efektin statistikor të krahasimit me nivelin e ulët të regjistruar një vit më parë (0.7%). Në aspektin makroekonomik, trendi rritës i inflacionit pasqyron shfrytëzimin më të madh të kapaciteteve prodhuese në ekonomi, shtimin e presioneve inflacioniste nga tregjet e huaja dhe ankorimin më të mirë të pritjeve inflacioniste.

Aktiviteti ekonomik është përshpejtuar në tremujorin e fundit të vitit të kaluar dhe prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 4% në nivel vjetor. Rritja ekonomike për gjithë vitin 2016 rezultoi 3.5%, duke shënuar një nivel më të lartë se vitet paraardhëse. Cikli rritës i ekonomisë është mbështetur nga zgjerimi i kërkesës së brendshme dhe të ardhurat e larta të gjeneruara nga aktiviteti turistik. Konsumi privat dhe investimet janë mbështetur nga normat e ulëta të interesit, përmirësimi i besimit në ekonomi, rritja e punësimit dhe nivelet e larta të investimeve të huaja direkte. Gjithashtu, zhvillimet ekonomike në ambientin e huaj kanë qenë pozitive, duke mbështetur rritjen e eksporteve. Ky zhvillim ishte më i dukshëm në fund të vitit 2016. Të dhënat e disponuara tregojnë për vazhdimësinë e këtyre tendencave edhe në tremujorin e parë të vitit 2017.

Politika monetare lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka krijuar një mjedis monetar të përshtatshëm për rritjen e kërkesës, të inflacionit dhe të pritjeve inflacioniste. Qëndrimi i politikës monetare është shprehur nëpërmjet ruajtjes së normës bazë të interesit në nivelin 1.25%, si dhe nëpërmjet komunikimit të kursit të ardhshëm të politikës monetare. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të furnizojë tregun bankar me likuiditetin e nevojshëm, duke ndihmuar aktivitetin ndërmjetësues dhe qëndrueshmërinë e normave të interesit në tregun e parasë.

Tregjet financiare kanë reflektuar politikën monetare lehtësuese dhe janë karakterizuar nga nivele të ulëta të normave të interesit. Rritja e *yield*-eve në tremujorin e fundit të vitit të kaluar ishte e përkohshme. Në tremujorin e parë të këtij viti ato kanë ndjekur një trajektore rënëse, në reflektim të përmirësimit të raportit kërkesë/ofertë dhe të politikave fiskale e monetare të pandryshuara. Gjithashtu, normat e interesit për huamarrësit janë në nivelet më të ulëta historike dhe kanë mbështetur kërkesën për kredi. Rritja e kredisë ka qenë më e dukshme për segmentin e individëve, për të cilin janë lehtësuar edhe kushtet "joçmim". Nga ana tjetër, kushtet "joçmim" për bizneset mbeten të shtrënguara. Kredia për biznese është e dobët, e ndikuar nga kërkesa e pakët, nga oferta e shtrënguar, nga rreziku i lartë i kredisë dhe nga gjendja e bollshme e likuiditetit të bizneseve.

Normat e ulëta të interesit në lekë kanë sjellë zhvendosjen e kreditimit në monedhën vendase. Pesha e këtij portofoli ka ardhur në rritje, duke përfaqësuar rreth 43.7% të kredisë dhënë për sektorin privat në muajin shkurt nga 40.6% një vit më parë. Kreditimi në lekë u zgjerua me 10.9% në dy muajt e parë të vitit, duke kompensuar performancën negative të kredisë në valutë. Rritja e kredidhënies në monedhën vendase krijon më shumë hapësira për transmetimin e stimulit monetar në ekonomi, si dhe redukton rreziqet e euroizimit për stabilitetin financiar.

Grafik 1. Normat e interesit në monedhën vendase



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Politika monetare do të vijojë të jetë lehtësuese edhe në horizontin afatmesëm. Kjo nënkupton ruajtjen e normave të interesit poshtë atyre ekuilibër. Ky qëndrim i politikës monetare është në përputhje me parashikimet afatmesme të Bankës së Shqipërisë. Këto parashikime sugjerojnë se rritja e aktivitetit ekonomik do të vijojë me ritme të ngjashme me ato të vitit 2016. Kushtet monetare janë lehtësuese dhe favorizojnë rritjen e investimeve private dhe të shpenzimeve konsumatore. Gjithashtu, zgjerimi i pritur i eksporteve pritet t'i japë shtysë rritjes ekonomike edhe në vitin 2017. Nga ana tjetër, planet afatmesme buxhetore sugjerojnë vijimin e konsolidimit fiskal me qëllim uljen e vulnerabiliteteve fiskale.

Shfrytëzimi më i madh i kapaciteteve prodhuese dhe rritja e punësimit kanë kontribuar në rritjen e presioneve të brendshme inflacioniste. Gjithashtu, presionet nga çmimet e huaja janë në rritje, ndonëse një pjesë e tyre është zbutur nga mbiçmimi i kursit të këmbimit. Inflacioni parashikohet të shënojë vlerën mesatare 2.3% në vitin 2017, kundrejt 1.3% vitin e kaluar. Përmirësimi i ekonomisë dhe mbyllja graduale e hendekut negativ të prodhimit pritet të sjellin rritje graduale të inflacionit drejt objektivit brenda vitit 2018.

Balanca e rreziqeve rreth skenarit bazë vlerësohet e orientuar poshtë në afat të shkurtër. Në kahun pozitiv, një përmirësim më i shpejtë se ai i pritur i besimit të agjentëve ekonomikë dhe i tregtisë së jashtme mund të zhvendosin rritjen ekonomike dhe inflacionin në një trajektore më të lartë sesa parashikimet tona. Në kahun negativ, pasiguria e prodhuar nga situata politike në vend mund të pasqyrohet në tkurrje të konsumit dhe të investimeve në ekonomi. Në afat të mesëm, rreziqet e kahut të poshtëm mbeten më dominuese, të lidhura kryesisht me pasiguritë në mjedisin e huaj dhe me shpejtësinë e rikuperimit të kredisë. Konfirmimi i pritjeve tona afatmesme dhe i balancës së rreziqeve rreth tyre, sugjeron se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm.

2. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË

Ambienti ekonomik dhe financiar ndërkombëtar është përmirësuar. Pritjet për zhvillimet ekonomike në të ardhmen janë pozitive. Megjithatë, rreziqet qëndrojnë në kahun e poshtëm, të lidhura me situatën politike në disa vende të Bashkimit Evropian dhe tensionet gjeopolitike. Efektet e këtyre rreziqeve mund të prekin edhe ekonomitë e vogla të rajonit, të cilat janë rritur me ritme të qëndrueshme. Rritja ekonomike e tyre pritet të përmirësohet gjatë vitit 2017, e nxitur më së shumti nga kërkesa e brendshme. Normat e inflacionit janë rritur në tremujorin e parë, por kjo rritje reflekton kryesisht ndikime afatshkurta dhe efekte statistikore nga rritja e çmimeve të mallrave bazë. Presionet e brendshme inflacioniste mbeten të ulëta. Tregjet financiare kanë faktorizuar përmirësimin e ekonomive të vendeve kryesore dhe zbutjen e primeve të rrezikut.

2.1. EKONOMIA BOTËRORE

Treguesit ekonomikë tregojnë për një konsolidim gradual të ekonomisë botërore gjatë tremujorit të parë 2017. Treguesit e përbërë botërorë të prodhimit[1] si dhe treguesi paraprijës i PBB-së regjistruan rritje tre muajt e parë, dhe konfirmuan ecurinë pozitive të aktivitetit ekonomik. Politikat monetare dhe fiskale në disa shtete kryesore kanë pasur karakter stimulues, duke e mbështetur ekonominë. Inflacioni regjistroi rritje në tremujorin e parë, ndonëse presionet inflacioniste vijojnë të mbeten përgjithësisht të ulëta, të reflektuara në nivelin e ulët të inflacionit bazë. Faktorë rreziku mbeten pasiguria mbi perspektivat e politikave ekonomike, si dhe ajo e lidhur me paqëndrueshmërinë politike në shtete dhe rajone të caktuara.

Grafik 2. Treguesi i përbërë paraprijës i PBB-së (CLI) dhe Prodhimi Industrial i vendeve kryesore* (majtas) dhe inflacioni (djathtas)



Burimi: Organizata e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik.
*Prodhimi industrial është ndryshim mujor, ndërkohë që trendi afatgjatë i CLI është 100.Vendet kryesore janë ato të OBZHE (OECD) dhe Brazil, Kinë, Rusi, Indi dhe Afrikë e Jugut.

[1] *The global composite output PMI dhe Global manufacturing PMI, Markit, janar, shkurt dhe mars 2017.*

Ekonomia e ShBA-së

Ekonomia e ShBA-së tregon përmirësim të qëndrueshëm, por me ritëm më të ngadaltë. Ekonomia u zgjerua me 2.0% në tremujorin e katërt 2016, nga 3.5% një tremujor më parë. Investimet publike dhe private rezultuan të dobëta dhe u kompensuan nga konsumi i rritur privat. Treguesit paraprakë flasin për ritme të zbutura të aktivitetit ekonomik në tremujorin e parë 2017. Shitjet janë ngadalësuar dhe punësimi në muajin mars rezultoi në nivele më të ulëta sesa pritej. Nga ana tjetër, treguesit e besimit janë në nivele të larta dhe të dhënat për pagat janë pozitive. Treguesi i përbërë i prodhimit, i cili i paraprin aktivitetit ekonomik, është gjithashtu në rritje këtë tremujor.

Aktiviteti ekonomik pritet të përshpejtohet gjatë vitit 2017, i mbështetur nga konsumi dhe pritjet për një politikë fiskale stimuluese në tremujorët e ardhshëm. Përmirësimi i ndjesisë së agjentëve financiarë dhe i biznesit krijojnë kushte për materializimin e këtyre pritjeve. Rezerva Federale ka rritur normën bazë të interesit, duke vijuar me ciklin shtrëngues të politikës monetare. Megjithëse inflacioni total ka ndjekur një trajektore rritëse, duke e tejkaluar edhe objektivin e Rezervës Federale, rritja e inflacionit bazë është e moderuar. Kjo ka bërë që Rezerva Federale të deklarojë se do të tolerojë inflacionin mbi 2.0% dhe të mënjanojë rrezikun për shtrëngimin e parakohshëm të kushteve monetare.

Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së T4-2016		Norma e papunësisë*		Norma vjetore e inflacionit	
	Tremujor	vjetor	12/2016	03/2017	T4/2016	T1/2017
ShBA	0.5	2.0	4.7	4.5	1.8	2.5
Eurozonë	0.5	1.8	9.6	9.5	0.7	1.8
Gjermani	0.4	1.8	3.9	3.9	1.1	1.9
Francë	0.4	1.1	10.0	10.0	0.5	1.1
Mbretëri e Bashkuar	0.7	1.9	4.8	4.7	1.2	2.1

Burimi: Eurostat dhe institutet statistikore përkatëse.
**Të dhënat e punësimit në Eurozonë dhe vendet anëtare janë deri në shkurt 2017.*

Ekonomia e Eurozonës

Ekonomia e Eurozonës ka ruajtur ecuri pozitive në tremujorin e fundit të vitit 2016. Forcimi i aktivitetit ekonomik po mbështetet vazhdimisht nga gjallërimi i konsumit, ndërkohë që edhe investimet po japin kontribut pozitiv. Rritja e shpenzimeve konsumatore ka reflektuar përmirësimin e tregut të punës dhe kushtet më të favorshme të kreditimit, si pasojë e lehtësimit të politikës monetare. Treguesit paraprakë në tremujorin e parë të vitit 2017, flasin për vijim të rritjes ekonomike me të njëjtat ritme si në vitin 2016. Inflacioni ka vijuar të rritet në muajt e parë të këtij viti, duke larguar kështu rrezikun e një spiraleje të mundshme dezinflacioniste. Gjithsesi, rritja e tij gjatë kësaj periudhe i dedikohet kryesisht çmimeve të produkteve të freskëta bujqësore dhe ndryshimit të lartë të çmimeve të naftës nga një vit më parë, ndërsa inflacioni bazë vijon të jetë

i ulët. Rritja ekonomike në Eurozonë pritet të jetë pozitive dhe e qëndrueshme për periudhën në vazhdim. Rreziqet rreth këtyre pritjeve mbeten të larta, të lidhura kryesisht me pasigurinë e situatës politike në disa vende të mëdha të BE-së dhe të rajoneve partnere kryesore të saj.

Ekonomitë e vendeve partnere tregtare të Shqipërisë, Italia dhe Greqia, kanë shfaqur dinamika të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Italia ka shfaqur vijim të rritjes ekonomike në tremujorin e fundit 2016. Rimëkëmbja e ekonomisë italiane gjatë gjysmës së dytë të vitit ka përfituar nga rritja e investimeve dhe nga forcimi i konsumit. Treguesit paraprakë të dinamikës së PBB-së flasin për vijimin me të njëjtat ritme të rritjes ekonomike edhe në tremujorin e parë të vitit 2017. Ekonomia e Greqisë është tkurrur ndjeshëm në tremujorin e katërt 2016, duke reflektuar zvogëlimin e investimeve dhe të shpenzimeve për konsum. Situata në të ardhmen përmban pasiguri që krijohen nga problemet e mundshme me menaxhimin e borxhit sovran. Sikurse në vendet e tjera të Eurozonës, inflacioni ka ndjekur një prirje rritëse në të dy këto shtete në tremujorin e parë.

Grafik 3. Indeksi i përbërë i prodhimit (PMI), PBB-ja tremujore dhe treguesi i ndjesisë ekonomike (majtas) dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin dhe konsumatorët (djathtas)



Burimi: Markit, Eurostat, Komisioni Evropian.

Ekonomitë e Rajonit[2]

Rritja ekonomike e vendeve kryesore partnere tregtare në Ballkan është forcuar gjatë vitit 2016, e mbështetur kryesisht nga investimet dhe konsumi privat, dhe më pak nga eksportet (Serbi, Maqedoni). Përjashtim në këtë tendencë bën Turqia, ekonomia e të cilës u ngadalësua ndjeshëm si pasojë e tensioneve të brendshme politike. Perspektiva ekonomike e vendeve partnere të rajonit për vitin 2017 është pozitive. Rritja ekonomike pritet të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, ndërsa rreziqet burojnë nga kursi i zhvillimeve në ekonomitë e mëdha dhe tensionet e brendshme politike (Maqedoni, Turqi).

[2] *Vendet kryesore partnere tregtare në Ballkan, joanëtare të BE-së.*

Normat e inflacionit tregojnë rritje në të gjitha vendet. Çmimet më të larta të ushqimeve dhe të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare janë faktorët kryesorë për rritjen e inflacionit.

Aktiviteti ekonomik nuk ka njohur ritme të njëjta për të gjitha vendet njëkohësisht. Serbia ka shënuar rritjen më të shpejtë të ekonomisë, në 2.8% në vitin 2016 nga 0.8% një vit më parë. Rritja ekonomike në tremujorin e katërt u mbështet nga zgjerimi i konsiderueshëm i eksporteve dhe nga konsumi publik dhe privat. Të dhënat paraprake për tremujorin e parë flasin për zgjerimin e qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik. Ekonomia e Maqedonisë regjistroi ritëm më të ulët rritjeje në vitin 2016, në 2.8% nga 3.5% vitin e kaluar, e ndikuar nga rënia e investimeve. Kriza politike në Maqedoni duket të ketë ndikuar klimën e biznesit[3]. Në tremujorin e katërt, tkurrja e investimeve thelloi edhe më tepër kontributin negativ. Nga ana tjetër, zgjerimi i shpenzimeve konsumatore dhe ai i eksporteve kanë kontribuar pozitivisht. Rritja ekonomike në Kosovë është udhëhequr kryesisht nga zgjerimi i investimeve dhe i shpenzimeve private. Eksportet neto kanë dhënë një kontribut negativ, si pasojë e rritjes së lartë të importeve në përgjigje të konsumit të rritur dhe investimeve të larta. Ky profil i aktivitetit ekonomik pritet të ruhet edhe gjatë këtij viti. Ekonomia e Turqisë vlerësohet të jetë rritur me 2.9% në vitin 2016, ndjeshëm më ulët se rritja prej 6.1% vitin e kaluar. Pas vlerës negative të rritjes vjetore në tremujorin e tretë të vitit 2016, tremujori i katërt shënoi rritje pozitive prej 3.5%, i mbështetur nga konsumi dhe investimet (publike dhe private). Të dhënat për tremujorin e parë 2017 janë pozitive dhe flasin për ritme rritjeje të ngjashme me vitin 2016. Treguesit e besimit konsumator dhe të biznesit janë stabilizuar në nivele më të larta se në fund të vitit të kaluar.

Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet fqinje

Vendet	Ndryshimi vjetor i PBB-së		Inflacioni vjetor	Norma e papunësisë
	T3-2016	T4-2016	T1-2017	T4 - 2016
Itali	1.0	1.0	1.3	11.5†
Greqi	2.0	-1.1	1.4	23.5*
Maqedoni	2.0	2.4	0.5	23.1
Serbi	2.8	2.5	3.1	13.0
Turqi	-1.3	3.5	10.2	12.4
Kosovë	3.8	3.0	1.6	27.5
Shqipëri	3.1	4.0	2.4	14.2

Burimi: Institutet statistikore përkatëse.
*Shënim: *Vlera për muajin janar 2017; †Vlera për muajin shkurt 2017.*

Normat e inflacionit në rajon kanë ndjekur një prirje rritëse në tremujorin e parë 2017. Në Maqedoni ai ka kaluar në territor pozitiv, dhe në Serbi ka hyrë brenda intervalit të objektivit të bankës qendrore. Ky përshpejtim konsiderohet i përkohshëm, pasi reflekton faktorë të ofertës të lidhur me çmimin e lartë të ushqimeve të shkaktuar nga kushtet e këqija klimaterike në muajt e parë të vitit. Inflacioni bazë mbetet në nivele të ulëta. Në Turqi, inflacioni shënoi vlera

[3] *Pasi u shtynë disa herë gjatë vitit, zgjedhjet parlamentare u bënë në dhjetor 2016. Pas rezultatit të zgjedhjeve nuk u arrit dakordësia për krijimin e një qeverie, situatë e cila e ka çuar vendin në krizë politike.*

dyshifrore, ndjeshëm mbi objektivin 5.0% të bankës qendrore, duke pasqyruar çmimet e larta të ushqimeve dhe efektin e vonuar të zhvlerësimit të lirës turke.

2.2. ECURIA E ÇMIMEVE TË MALLRAVE KRYESORE NË TREGJET BOTËRORE

Çmimet e mallrave bazë kanë vijuar rritjen në tremujorin e parë, duke ndjekur përmirësimin e aktivitetit ekonomik në botë. Indeksi kryesor i çmimeve të mallrave bazë u rrit me 6% nga tremujori i kaluar, dhe 35% nga një vit më parë. Nga grupet e mallrave, ato me rritjen më të fortë kanë qenë çmimet e produkteve të naftës. Çmimet e tyre kërcyen në janar dhe në shkurt, duke reflektuar besimin e tregut tek marrëveshja midis vendeve të OPEC-ut dhe disa vende jashtë OPEC-ut për reduktimin e prodhimit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017. Çmimi i naftës Brent u luhat në intervalin 54–57 USD/fuçi në këto dy muaj dhe indeksi i këtij malli shënoi një rritje vjetore prej rreth 70%. Në muajt mars e prill, çmimi i naftës është luhatur ndjeshëm. Optimizmi i tregut u shua në muajin mars, me rritjen e prodhimit në SHBA dhe me dyshimet se marrëveshja e OPEC-ut nuk do të mjaftonte për të krijuar presione në çmimin e naftës. Kjo ndikoi në rënien e çmimit këtë muaj. Megjithatë, shtimi i tensioneve gjeopolitike dhe deklaratat nga autoritetet për respektimin e marrëveshjes bënë që çmimi të rritej përsëri në muajin prill, pranë niveleve të fillimvitit.

Rritje kanë njohur dhe çmimet e metaleve, në përgjigje të perspektivës për rritje të investimeve në vendet në zhvillim, ulje të kapaciteteve prodhuese në disa miniera dhe një politikë fiskale stimuluese në ShBA. Çmimet e ushqimeve janë rritur më pak dhe kanë pasur ecuri të ndryshme brenda grupeve. Ato të drithërave kanë reflektuar pritjet për prodhim më të ulët dhe konsum më të lartë, duke shënuar rritje të moderuar.

Grafik 4. Ndryshimet vjetore të çmimeve të mallrave bazë



Burimi: EIA, FMN, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Çmimet e produkteve të naftës dhe shumicës së metaleve pritet të mbeten në nivelet aktuale deri në fund të vitit 2017. Për pjesën më të madhe të ushqimeve, çmimet priten të rriten si pasojë e kushteve jo të mira klimaterike[4].

2.3. TREGJET FINANCIARE

Grafik 5. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore



Burimi: Bankat qendrore (BQE, Fed, BJ dhe BA).

Komiteti Federal i Tregut të Hapur (FOMC) i FED-it, në mbledhjen e muajit mars, ka rritur normën bazë me 0.25 pikë përqindje në 0.75%-1.00%. Bankat e tjera qendrore kryesore i kanë lënë të pandryshuara normat e tyre bazë të interesit respektivisht, BQE-ja në 0.0%, Banka e Anglisë në 0.25% dhe Banka e Japonisë në -0.1%.

Kushtet në tregjet financiare janë paraqitur të lehtësuara në tre muajt e parë të vitit 2017. Indekset e aksioneve në ekonomitë e zhvilluara kanë shfaqur rritje. Diferenca midis *yield*-eve të titujve me vlerësim maksimal dhe atyre të renditur më poshtë nga agjencitë e vlerësimit është ngushtuar. Rritja e kërkesës për këta tituj tregon për një përmirësim të klimës së besimit tek agjentët e tregut. Flukset hyrëse të kapitaleve në ekonomitë në zhvillim janë kthyer pozitive dhe monedhat e këtyre vendeve kanë treguar një mbiçmim të përgjithshëm.

Interesat e instrumenteve në tregun e parasë në Eurozonë nuk kanë ndryshuar, duke mbetur në nivele të ulëta. Interesat e kuotuara në monedhën amerikane janë rritur, duke reflektuar ndryshimin në politikën monetare të Rezervës

Grafik 6. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Bloomberg, Reuters dhe Eurostat.

[4] *Parashikime të FMN-së, prill 2017 (World Economic Outlook).*

Federale. Normat afatgjata të interesit në Eurozonë janë rritur, duke reflektuar kryesisht përmirësimin e kushteve ekonomike, por edhe një rritje të primeve për rrezikun sovran. Gjatë këtyre tre muajve, euro është nënçmuar ndaj dollarit amerikan dhe disa prej monedhave kryesore. Në terma mesatarë krahasuar me tremujorin e fundit të vitit 2016, euro u nënçmua me 1.3% ndaj dollarit amerikan.

3. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE

Tregjet financiare kanë qenë të qeta në tremujorin e parë të vitit, në prani të primeve të ulëta të rrezikut dhe të niveleve të kënaqshme të likuiditetit. Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë i janë rikthyer prirjes rënëse me përmirësimin e raportit kërkesë/ofertë. Luhatjet e tyre nuk janë transmetuar në segmentet e tjera të tregut dhe normat e interesit ndodhen pranë vlerave minimale të tyre. Politika monetare lehtësuese e Bankës së Shqipërisë është reflektuar në uljen e kostove të financimit për sektorin privat. Zhvillimet në kredi konfirmojnë zhvendosjen e portofolit drejt kredisë në lekë, rritja e të cilës ka kompensuar tkurrjen e kredisë në valutë. Rritja e portofolit total të kredisë vijon e ngadaltë, duke ndikuar ritmin e zgjerimit monetar. Kështu, presionet inflacioniste me natyrë monetare mbeten të ulëta për periudhën afatmesme.

3.1. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Tregu ndërbankar

Tregu ndërbankar ka vijuar të karakterizohet nga norma të ulëta interesi gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Vëllimi i tregtuar nga bankat ka qenë i ngjashëm me atë të fundit të vitit 2016. Interesat për shkëmbimin e fondeve midis bankave kanë vijuar të luhaten pranë normës bazë dhe treguesit e luhatshmërisë së tyre kanë ruajtur nivele të ulëta. Likuiditeti në treg ka qenë i kënaqshëm, duke mbështetur këtë ecuri të normave të interesit. Profili i transaksioneve mbizotërohet nga maturiteti ditor dhe ai javor, ku pesha e vëllimeve është në favor të këtij të fundit. Krahas këtyre maturiteteve janë shtuar edhe transaksionet 2- apo 3-ditore. Banka e Shqipërisë ka vijuar të ofrojë likuiditet me anë të instrumentit

Grafik 7. Operacionet e tregut të hapur të BSh (majtas) dhe normat e interesit në tregun ndërbankar (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

të saj kryesor, repos 7-ditore, si dhe marrëveshjeve repo me maturitet 1- dhe 3-mujor. Shuma e injektuar ka qenë lehtësisht më e vogël se tremujori i kaluar.

Tregu i brendshëm valutor

Ecuria e monedhës vendase ka vijuar të karakterizohet nga sjellje mbiçmuese, si në terma efektivë, ashtu edhe në ato bilateralë, gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Ndryshimi vjetori i kursit nominal efektiv[5] rezultoi -3.5% në tre muajt e parë të vitit, nga -3.2% në tremujorin e mëparshëm dhe njëkohësisht gjatë vitit 2016. Thellimi i mbiçmimit efektiv në këtë periudhë ka reflektuar kryesisht mbiçmimin e ndjeshëm të lekut ndaj lirës turke, vlera e së cilës ka rënë në masë të konsiderueshme kundrejt dollarit amerikan. Ecuria në terma realë[6] ka qenë e qëndrueshme. Indeksi i kursit real efektiv është mbiçmuar me mesatarisht 4.0% në tremujorin e parë të vitit, ritëm i ngjashëm ky me atë të vërejtur në tremujorin paraardhës. Forcimi i mbiçmimit nominal është balancuar nga ngushtimi i diferencës së inflacionit në vend me atë të vendeve partnere evropiane.

Grafik 8. Ecuria e kursit të këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tendencat mbiçmuese të lekut kundrejt monedhës evropiane kanë qenë të pranishme edhe në tremujorin e parë të vitit. Me prapësimin e mbiçmimit sezonal të muajit dhjetor, kursi euro/lek u rrit në 136.6 në muajin janar, për të rënë në 135.6 në muajin shkurt e në 135.4 në muajin mars. Në terma vjetorë, vlera e lekut kundrejt euros u rrit me mesatarisht 1.8%, ritëm ky i ngjashëm me atë të tremujorit të fundit të vitit 2016. Në tërësi, ecuria e kursit euro/lek ka reflektuar raportin më të lartë të ofertës së euros kundrejt kërkesës së ekonomisë

[5] *Kursi nominal efektiv i këmbimit (KNEK/NEER) llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë (Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe Kina), duke përdorur peshat përkatëse në tregti. Me qëllim përllogaritjen e kursit lira/lek dhe renminbi/lek, kursi zyrtar referues mbetet ai i lirës turke dhe renminbit kinez ndaj dollarit amerikan.*

[6] *Kursi real efektiv i këmbimit (KREK/REER) llogaritet në mënyrë të ngjashme si ai nominal, por merr parasysh edhe inflacionin në vend dhe në partnerët tregtarë.*

vendase për të. Ky fenomen ka qenë veçanërisht i spikatur në gjysmën e dytë të vitit të kaluar, kur ekonomia vendase përjetoi përshpejtim të eksporteve dhe ngadalësim të importeve, si dhe flukse të shtuara nga turizmi, remitancat dhe nga financimet e huaja të lidhura me projekte të mëdha të investimeve. Zhvillimet e vërejtura gjatë muajit prill tregojnë për luhatje të kurseve euro/lek pranë niveleve mesatare të muajit mars.

Leku ka shfaqur sërish prirje mbiçmuese kundrejt monedhës amerikane gjatë tremujorit të parë të vitit. Pasi qëndroi pranë nivelit mesatar të dhjetorit edhe gjatë muajit janar, prej 128.4, kursi usd/lek ra në 127.4 në muajin shkurt e më tej në 126.7 në muajin mars. Në terma vjetorë, leku vijon të jetë i nënçmuar kundrejt monedhës amerikane, me mesatarisht 1.6%. Zhvillimet e vërejtura në kursin usd/lek janë përgjithësisht në linjë me ecurinë e monedhës së gjelbër në tregun ndërkombëtar.

Tregu primar

Në tregun primar të instrumenteve të borxhit të qeverisë, *yield*-et e bonove të thesarit dhe të obligacioneve kanë ndjekur ecuri rënëse. *Yield*-et kthyen kah në fundin e muajit janar, duke përfunduar trajektoren rritëse që kishte mbizotëruar në pjesën e dytë të vitit të kaluar. Ulja e *yield*-eve ka reflektuar përmirësimin e raportit ofertë/kërkesë. Kërkesa e qeverisë për financim ka qenë e lartë në tremujorin e parë, por pjesëmarrja dhe oferta e bankave në ankande është rritur, duke diktuar prirjen rënëse tek *yield*-et. Ulja e *yield*-eve ka qenë e pranishme tek të gjitha maturitetet, por me intensitet të ndryshëm – ajo ka qenë më e fortë në maturitetet 12- dhe 24-mujore. Për rrjedhojë, kurba e *yield*-eve është zhvendosur për poshtë dhe pjerrësia e saj është rritur kundrejt fillimit të vitit.

Yield-i 12-mujor rezultoi 1.79% në fillimin e muajit prill, nga niveli prej 3.22% që shënonte në muajin janar. *Yield*-i i obligacionit 2-vjeçar (i cili ka emetime të

Grafik 9. *Yield*-et në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

rregullta mujore) u ul në 2.25% në ankandin e muajit prill, nga 3.80% në janar. Në ankandet e obligacioneve 5-, 7- dhe 10-vjeçare (emetime tremujore), *yield*-et rezultuan përkatësisht 5.15%, 5.24% dhe 6.45%, nga 5.25%, 5.98% dhe 7.20%, që kishin shënuar në ankandet paraardhëse respektive. Kërkesa për të blerë obligacione ka njohur rritje në tremujorin e parë[7], duke konfirmuar rritjen e interesit të bankave për këto instrumente investimi.

3.2. NORMAT E INTERESIT TË DEPOZITAVE DHE KREDIVE DHE KUSHTET E FINANCIMIT[8]

Interesat për depozitat e reja në lekë, pasi ruajtën nivele të krahasueshme me ato të tremujorit të mëparshëm, prej 0.83% në janar, kanë shënuar rritje në muajin shkurt, në 0.98%. Rritja ka qenë e dallueshme në depozitat me maturitet 6-, 12- dhe 24-mujor. Analiza e detajuar tregon se rritja e interesave të depozitave në muajin shkurt nuk është me bazë të gjerë, por reflekton sjelljen e dy bankave të sistemit. Duke përjashtuar këto dy banka nga llogaritjet, norma e interesit të depozitave rezulton pranë nivelit mesatar të gjashtëmujorit të dytë të vitit të kaluar. Normat e interesit për depozitat e reja në euro kanë qëndruar pranë nivelit mesatar të tremujorit të fundit të vitit 2016, duke shënuar 0.16%.

Grafik 10. Normat e interesit për depozitat e reja me afat



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga këndvështrimi i ndërmjetësimit financiar, kostoja e financimit të aktivitetit bankar mbetet në nivele të ulëta historike. Interesi i depozitave në lekë është në vlerat minimale të tij, në reflektim të politikës monetare lehtësuese dhe të situatës së mirë të likuiditetit në sistemin bankar. Në kushtet e përmirësimit të bilanceve

[7] *Treguesi bid/cover për ankandet e zhvilluara në muajt janar, shkurt dhe mars për obligacionet ishte 1.66 nga 0.98, që ishte në tremujorin e fundit.*

[8] *Të dhënat më të fundit zyrtare për normat e interesit për kreditë dhe depozitat e reja i përkasin muajit shkurt 2017.*

të bankave dhe të rritjes progresive të aktivitetit ekonomik, reduktimi i kostos së financimit të sistemit bankar është përkthyer në norma më të ulëta financimi për sektorin privat.

Interesat për kredinë e re në lekë kanë treguar ecuri rënëse në tremujorin e parë të 2017-ës. Norma mesatare e interesit rezultoi 7.36% nga 7.75%[9], që ishte në tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Ecuria e normave të interesit të kredive në muajt janar dhe shkurt nuk ka qenë e njëjtë për të gjitha segmentet. Interesat e kredisë janë ulur për bizneset private, ndërsa kanë shënuar rritje për individët. Norma mesatare e kredisë për bizneset ka rezultuar 7.33% nga 8.03% që ishte në tremujorin e katërt. Brenda segmentit të bizneseve, normat e interesit janë ulur për kreditë për likuiditet dhe janë rritur për ato për investime. Interesat për kreditë për individë janë rritur në të gjitha segmentet, si për financimin e konsumit, ashtu edhe për kreditë hipotekare. Ecuria e luhatshme e *yield*-eve nuk është përkthyer në luhatshmëri të normave të interesit të kredive, por rritja e tyre në muajt e fundit të vitit të kaluar ka ushtruar presione për rritjen e normave të interesit për kreditë afatgjata në përgjithësi dhe veçanërisht për kreditë për individë.

Grafik 11. Normat e interesit për kredinë e re, mesatare rrëshqitëse 6-mujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesi mesatar për kredinë e re në euro shënoi një ulje të lehtë në këtë tremujor. Në terma mesatarë, ai rezultoi 4.62%, nga 4.71% që shënonte në tremujorin e mëparshëm. Në tërësi, si bizneset private ashtu edhe individët kanë përfituar nga rënia e interesave për kreditë në euro. Tek bizneset, rënia e interesave vërehet tek kreditë për likuiditet, ndërsa interesi për kreditë për investime vijon të qëndrojë në nivele minimale. Individët kanë përfituar norma më të ulëta për kreditë hipotekare, në një kohë që normat e interesit për kreditë konsumatore janë rritur. Diferenca e normës mesatare të kredisë në lekë kundrejt asaj në

[9] *Llogaritja e mesatares së tremujorit të katërt është bërë, duke përjashtuar nga llogaritjet një kredi të dhënë një kompanie publike me normë interesi preferenciale në muajin dhjetor.*

euro është ulur këto dy muaj, si rezultat i rënies më të madhe të interesave për kredinë në lekë. Kjo diferencë qëndron lehtas mbi mesataren e vitit të kaluar.

Grafik 12. Kushtet e kreditimit
(për biznese majtas, për individë djathtas)



Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kreditues, Banka e Shqipërisë.

Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e parë të vitit 2017 tregojnë shtrëngim të standardeve të kreditimit për bizneset, për të katërtin tremujor radhazi. Ky shtrëngim ka qenë i pranishëm si për kreditë për investime, ashtu edhe për ato për likuiditet, dhe është shprehur kryesisht nëpërmjet rritjes së mëtejshme të kërkesave për kolateral, dhe në një masë të vogël, nëpërmjet uljes së madhësisë së kredisë. Ndërkohë, lehtësimi i standardeve të kreditimit në segmentin e individëve ka vijuar, si për kreditë konsumatore, ashtu edhe për ato hipotekare. Përqasja lehtësuese e bankave ndaj këtij segmenti është materializuar nëpërmjet uljes së kërkesave për kolateral dhe përmirësimit të raportit kësti/të ardhura.

3.3. KREDITIMI I SEKTORIT PRIVAT[10]

Zhvillimet në kredi tregojnë për rritjen e saj të moderuar, por të qëndrueshme gjatë dy viteve të fundit. Kredia për sektorin privat u rrit mesatarisht me 2.9% në muajt janar e shkurt, pas normës 3.3% të rritjes në tremujorin e kaluar. Në terma mujorë, teprica e kredisë për sektorin privat u tkurr në janar, dhe u rrit lehtësisht në shkurt, duke rezultuar rreth 1.9 miliardë lekë më pak se fundi i vitit 2016. Ritmet e ngadalta të kreditimit reflektojnë ofertën ende të shtrënguar të sektorit bankar për segmentin e bizneseve. Ndërkohë, rritja e tij është mbështetur kryesisht nga kredia për individë, në reflektim të një kërkese më të qëndrueshme, si edhe të kushteve më të lehtësuara nga ana e ofertës.

[10] *Analiza e kredisë bazohet në të dhënat monetare të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci.*

Raporti i tepricës së kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së vlerësohet në rreth 37% në fund të muajit shkurt.

Në terma të zhvillimeve sipas monedhës, kredia në lekë ka mbështetur plotësisht zgjerimin e kredisë për sektorin privat, duke kompensuar tkurrjen e stokut të kredisë në monedhë të huaj. Rënia e kostos së financimit në lekë, politikat e kreditimit të bankave, kombinuar edhe me ndërgjegjësimin e agjentëve ekonomikë për rrezikun e ekspozimit ndaj kursit të këmbimit, janë materializuar në rritjen e kredidhënies në lekë. Teprica e kësaj kredie zë rreth 43.7% të kredisë për sektorin privat në muajin shkurt, krahasuar me 40.6% në të njëjtën periudhë një vit më parë. Portofoli i kredisë në lekë ka përshpejtuar normën e rritjes vjetore në 10.9%, ndërsa ajo në valutë rezulton mesatarisht 2.5% më e ulët se një vit më parë. Tendenca mbiçmuese e monedhës vendase kundrejt monedhave kryesore, USD dhe Euro, ka ndikuar në thellimin e kësaj tkurrjeje. Pastruar nga ky efekt, norma vjetore e rënies së portofolit të kredisë në valutë rezulton më e zbutur.

Grafik 13. Kredia për sektorin privat sipas monedhës dhe agjentëve ekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma të zhvillimeve sipas klientit, zgjerimi i kredisë është mbështetur nga rritja e kredisë për individë. Kredia për individë shfaq rritje të qëndrueshme me thuajse të njëjtat ritme si një tremujor më parë. Ajo ka përfituar nga lehtësimi i vazhdueshëm i kushteve për individët, kombinuar njëkohësisht me kërkesën në rritje të tyre për financim nga sektori bankar. Në terma mesatarë vjetorë, teprica e kredisë për individë u rrit me rreth 5.3% në muajt janar-shkurt. Zgjerimi i këtij portofoli mbështetet si nga performanca e mirë e kredisë për konsum, ashtu edhe nga financimi për kredi hipotekare. Teprica e kredisë hipotekare shfaqi rritje vjetore më të lartë se ajo e një tremujori më parë (4.5% përkundrejt 3.7%). Ndërsa kredia konsumatore ngadalësoi normën e rritjes me 0.4 pikë përqindje në 9.9% për të njëjtën periudhë. Ndryshimet mujore të stokut total të kredisë për individë tregojnë për rritje, me rreth 0.3 miliardë lekë nga fundi i vitit të kaluar.

Grafik 14. Ecuria e kredisë sipas agjentëve ekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për biznese ka vijuar të shfaqë rritje të plogësht e të paqëndrueshme. Ky portofol ngadalësoi normën vjetore të rritjes në rreth 1.8% në periudhën janar-shkurt, krahasuar me 2.4% në tremujorin e kaluar. Ndryshimet në tepricën e kredisë për biznese në terma mujorë tregojnë për rënie të saj me rreth 2.2 miliardë lekë nga fundi i vitit të kaluar. Ecuria e kredisë për biznese kushtëzohet nga oferta ende e shtrënguar për këtë segment, e përqendruar në segmentin e ndërmarrjeve të mëdha. Nga ana tjetër, edhe kërkesa për kredi rezulton e paqëndrueshme dhe e segmentuar[11]. Sipas qëllimit të përdorimit, kredia për investime shfaq rritje të qëndrueshme në kohë (3.6%). Në të kundërt, kredia për likuiditete (-0.3%) karakterizohet nga luhatshmëri më e lartë, duke reflektuar edhe maturitetin afatshkurtër të këtij portofoli si dhe gjendjen e mirë të likuiditetit të bizneseve.

Grafik 15. Deficiti buxhetor dhe instrumentet e financimit të tij, në miliardë lekë (kumulative)



Burimi: Ministria e Financave.

3.4. FINANCIMI I SEKTORIT PUBLIK

Politika e huamarrjes së qeverisë ka qenë e orientuar drejt instrumenteve afatgjata dhe në tremujorin e parë të vitit 2017, duke i shërbyer në këtë mënyrë zgjatjes së maturitetit të borxhit të brendshëm. Huamarrja në tregun e brendshëm ka qenë e diversifikuar si në terma të instrumenteve ashtu edhe të monedhës, dhe është shpërndarë në përputhje me kalendarin e emetimeve të letrave me vlerë.

[11] *Bazuar në vrojtimet e aktivitetit kredites, për më shumë: https://www.bankofalbania.org/web/Vrojtimi_i_aktivitetit_kredites_5311_1.php*

Në fund të muajit mars, huamarrja e brendshme rezultoi 11.2 miliardë lekë dhe u formua në masën më të madhe (rreth 90%) nga instrumentet afatgjata. Rreth 48% të shtesës së stokut të borxhit të brendshëm nga fundi i muajit dhjetor 2016 e ka sjellë emetimi i obligacionit 2-vjeçar në monedhën Euro. Pjesa tjetër është formuar nga obligacionet 7- dhe 10-vjeçare, si dhe bonot e thesarit, duke kompensuar edhe reduktimin e portofolit të obligacioneve 3-vjeçare me rreth 1.1 miliardë lekë.

Përsa i përket aktorëve të tregut të letrave me vlerë, roli i sistemit bankar mbetet dominues. Në fund të muajit mars, bankat zotërojnë rreth 58% të portofolit të letrave me vlerë të qeverisë përkundrejt 57% një vit më parë. Gjithashtu, prania e individëve në këtë treg është shtuar: në fund të muajit mars, individët zotërojnë rreth 25% të stokut të borxhit të letrave me vlerë.

3.5. ECURIA E DEPOZITAVE DHE E PARASË NË EKONOMI

Oferta monetare në ekonomi është zgjeruar në muajt janar-shkurt. Treguesi i parasë së gjerë, agregati M3, ka shënuar rritje me 3.9% në terma mesatarë vjetorë, nga 3.2% në tremujorin paraardhës. Mjetet valutore neto të sistemit bankar kanë vijuar të japin kontributin kryesor në zgjerimin e masës monetare. Kjo e fundit është mbështetur gjithashtu nga kontributi pozitiv i sektorit publik, ku pretendimet neto ndaj qeverisë reflektojnë pjesërisht efektin statistikor të rënies së tyre një vit më parë. Kontributi i kredisë për ekonominë në zgjerimin e parasë së gjerë është pozitiv, por mesatarisht më i ulët se një tremujor më parë. Agregati i parasë në lekë, M2, tregon për zgjerim të krijimit të parasë në monedhën vendase, duke shënuar normë mesatare vjetore rritjeje me 2.3% në muajt janar-shkurt, nga 0.6% një tremujor më parë. Aktiviteti i shtuar në lekë është mbështetur gjerësisht nga përqendrimi i kredidhënies në monedhë vendase dhe financimi i qeverisë në lekë. Treguesi i parasë së ngushtë, agregati

Grafik 16. Ecuria e treguesve monetarë



Burimi: Ministria e Financave.

M1, ka shënuar një normë vjetore rritjeje prej 14%. Tendenca rritëse e këtij treguesi reflekton kryesisht preferencën e agjentëve ekonomikë për mbajtjen e depozitave në formë likuide. Pas rritjes sezonale në fund të vitit, paraja jashtë bankave tregon reduktim të stokut në muajt janar-shkurt, në linjë me pritjet.

Depozitat në sistemin bankar[12] janë zgjeruar mesatarisht me 4.8% në terma vjetorë në muajt janar-shkurt, krahasuar me normën prej 4.5% në tremujorin e kaluar. Stoku total i depozitave në raport me PBB-në vlerësohet në rreth 72.8% në fund të muajt shkurt. Rritja e depozitave mbështetet nga performanca e mirë e depozitave në valutë (6.8%), si edhe përmirësimi në normat e rritjes së depozitave në lekë (2.8%). Zhvillimet afatshkurtra tregojnë për rënie të stokut të depozitave nga fundi i vitit të kaluar (me 5.6 miliardë lekë), e ndikuar nga reduktimi i depozitave në lekë gjatë kësaj periudhe. Ecuria e këtyre të fundit është ndikuar nga zhvendosja e kursimeve në instrumente alternative financiare, si letra me vlerë të qeverisë. Ndërkohë, depozitat në valutë kanë shënuar rritje të moderuar (0.2 miliardë lekë), e cila e pastruar nga efektet e mbiçmimit të monedhës vendase gjatë kësaj periudhe, rezulton lehtësisht më e lartë.

Grafik 17. Ecuria e depozitave në sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë

Zhvillimet në terma të strukturës kohore tregojnë se reduktimi i stokut të depozitave në periudhën janar-shkurt ka prekur kryesisht stokun e depozitave pa afat (3.9 miliardë lekë), dhe në një masë më të ulët ato me afat. Megjithatë, në terma afatgjatë, struktura kohore evidenton ende preferencën e agjentëve ekonomikë për mjete monetare likuide. Në fund të muajit shkurt, depozitat pa afat në sistemin bankar përbëjnë 39.8% të stokut në total.

[12] *Analiza e depozitave përfshin edhe depozitat me maturitet mbi dy vjet që nuk janë pjesë e llogaritjes së agregatit M3.*

4. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE

Inflacioni mesatar vjetor shënoi vlerën 2.4% në tremujorin e parë të vitit 2017, duke konfirmuar vlerësimet e Bankës së Shqipërisë për trendin rritës të tij gjatë kësaj periudhe. Rritja ka reflektuar forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste, si pasojë e përmirësimit të kërkesës agregate e të pozicionit ciklik të ekonomisë, shtimin e presioneve të huaja dhe ankorimin më të mirë të pritjeve inflacioniste. Në vlerësimin e Bankës së Shqipërisë, veprimi i këtyre faktorëve do të shtrihet edhe gjatë tremujorëve në vijim.

Rritja ekonomike e tremujorit të katërt, ashtu si pritej, u përshpejtua në nivelin 4%. Rritja e kërkesës agregate u mbështet nga kontributi pozitiv i të gjithë komponentëve të saj, por ndikimi kryesor erdhi nga rritja e eksporteve. Nga ana e prodhimit, zgjerimi i aktivitetit ekonomik u mbështet kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe aktiviteti ndërtues. Të dhënat e disponuara për tremujorin e parë të vitit sugjerojnë vazhdimin e këtyre tendencave.

Ekonomia shqiptare pritet të rritet me ritme të qëndrueshme për periudhën në vazhdim, duke sjellë një aktivizim më të plotë të kapaciteteve prodhuese në vend. Afrimi i ekonomisë me ekuilibrin do të shoqërohet me rritjen e presioneve inflacioniste dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2018.

4.1. ECURIA E INFLACIONIT

Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 2.4% në tremujorin e parë të vitit 2017, duke qëndruar 0.5 pikë përqindje më lart se në tremujorin paraardhës. Rritja e inflacionit u përcaktua kryesisht nga rritja e çmimeve të produkteve ushqimore, të cilat formuan rreth 80% të normës totale të inflacionit. Gjithashtu, çmimi i karburanteve vijoi të jetë dukshëm më i lartë se një vit më parë. Vlerat e

Grafik 18. Inflacioni vjetor dhe objektivi (majtas). Inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

inflacionit në tremujorin e parë të vitit reflektuan edhe efektin bazë të krahasimit me nivelin e ulët të regjistruar një vit më parë (0.7%). Prirja rritëse e inflacionit gjatë këtij tremujori rezultoi në linjë me parashikimet tona të mëparshme.

Ecuria e inflacionit gjatë tre muajve të parë të vitit shfaqi prirje ngadalësuese, duke u reduktuar nga 2.8% në muajin janar në 2.1% në muajin mars. Kjo ecuri u përcaktua nga ngadalësimi i kontributit të vërejtur në kategorinë "Ushqime të papërpunuara". Inflacioni vjetor i kësaj kategorie shënoi normën 10.1% në muajin janar, duke kontribuar me 1.7 pikë përqindje në inflacionin total. Rritja e çmimeve të ushqimeve në janar u ndikua si nga rritja e tyre në tregjet e huaja, ashtu dhe nga moti i keq në vend. Me shuarjen e efektit klimaterik, inflacioni i kësaj kategorie shënoi vlera më të ulëta. Kontributi i saj në inflacionin total ra në 1.0 pikë përqindje, në muajin shkurt dhe në mars.

Grafik 19. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Kategoria tjetër e produkteve ushqimore, ajo e ushqimeve të përpunuara ka kontribuar në masë të njëjtë me atë të tremujorit të kaluar në inflacionin total, me 0.6 pikë përqindje. Ky zhvillim reflekton edhe tendencën rritëse të çmimeve të mallrave ushqimore në tregjet ndërkombëtare.

Rritje të normës së inflacionit dhe të kontributit pati edhe në grupin e mallrave "Mallra konsumi joushqimor". Kontributi pozitiv i kësaj kategorie ka ardhur si pasojë e rritjes së çmimit të naftës në vend, në pasqyrim të rritjes së saj në tregjet ndërkombëtare, e rritjes së çmimit të gazit për konsum dhe e efektit të bazës së ulët krahasuese të vitit të kaluar. Pavarësisht se nuk solli ndryshime të dukshme në vlerat e kontributit tremujor, inflacioni i kategorisë "Strehim" shënoi rritje në muajin mars. Ky zhvillim u shkaktua nga rritja e indeksit të qirasë. Kategoritë e tjera të shportës ruajtën pothuajse të njëjtin kontribut në inflacionin total.

*Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)**

	T1:15	T2:15	T3:15	T4:15	T1:16	T2:16	T3:16	T4:16	T1:17
Ushqime të përpunuara (pp)	0.3	0.2	0.1	0.0	-0.4	0.1	0.4	0.6	0.6
Bukë dhe drithëra (pp)	0.0	0.0	0.0	-0.1	-0.2	-0.1	0.0	0.1	0.1
Alkool dhe duhan (pp)	0.3	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Ushqime të papërpunuara (pp)	1.7	1.8	1.8	2.6	1.5	0.9	1.2	0.9	1.3
Fruta (pp)	0.5	0.8	0.8	0.9	0.7	0.6	0.4	0.2	0.3
Perime(pp)	1.1	0.9	0.9	1.7	0.8	0.3	0.8	0.6	0.9
Shërbime (pp)	0.1	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.2	0.0	0.0
Mallra me çmime të rregulluara (pp)	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0
Strehim (pp)	0.1	-0.1	0.0	-0.2	-0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
Mallra konsumi joushqimor	-0.4	-0.2	-0.2	-0.3	-0.3	-0.3	-0.1	0.3	0.5
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0
Indeksi i çmimeve të konsumit (ndryshim vjetor %)	1.9	1.8	1.8	2.1	0.7	0.7	1.9	1.9	2.4

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

Sikurse u përmend, rritja e shpejtë e inflacionit është ndikuar kryesisht nga faktorë të ofertës. Presionet inflacioniste nga ana e kërkesës, megjithëse në rritje, mbeten të përmbajtura. Normat pozitive të rritjes ekonomike dhe të punësimit kanë zbutur hendekun midis prodhimit aktual dhe atij potencial, por nuk e kanë eliminuar atë. Gjithashtu, sjellja mbiçmuese e kursit të këmbimit ka frenuar presionet që vijnë nga çmimet e huaja të mallrave bazë (naftës, ushqimeve bazë, drithërave etj.). Nga ana tjetër, ankorimi më i mirë i pritjeve inflacioniste krijon kushte për rritjen e qëndrueshme të inflacionit.

HAPËSIRË INFORMUESE 1: INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT KUNDREJT INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT: DY TREGUES TË NDRYSHËM[I]

Kjo hapësirë është hartuar për të dhënë disa informacione më të detajuara në lidhje me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK), qëllimit të përdorimit dhe dallimeve të tij me IÇK-në, veçanërisht, në rastin e Shqipërisë.

Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), është një tregues i njohur gjerësisht nga publiku si indeks që përdoret për llogaritjen e inflacionit. Në Shqipëri, matet dhe publikohet nga INSTAT-i. IÇK me frekuencë mujore daton nga janari i vitit 1992. IÇK-ja llogaritet në nivel kombëtar dhe është pjesë e treguesve makroekonomikë më të rëndësishëm. Metodologjitë për matjen e IÇK-së janë përsosur, duke synuar harmonizimin e metodave dhe të teknikave matëse në përshtatje me kushtet e vendeve. Në thelb, zbatimi i metodologjive statistikore siguron cilësinë e procesit të llogaritjes së indekseve të çmimeve të konsumit dhe të inflacionit. Me gjithë standardizimin e metodologjive, nuk arrihet të eliminohen diferencat ndërmjet IÇK-ve dhe inflacioneve që lidhen me veçoritë e ekonomive të ndryshme. Kjo sjell vështirësi në krahasimin e treguesve përkatës ndërmjet vendeve, për më tepër, në nivelin e vendeve anëtare dhe kandidate të BE-së.

Për të ndihmuar hartimin e politikave dhe për të realizuar një krahasueshmëri sa më të mirë me vendet e tjera, në bashkërendim me Eurostat[II]*, janë ndërmarrë hapa në drejtim të krijimit të një baze të përbashkët metodologjike të shteteve anëtare për ndërtimin dhe përdorimin e IHÇK-së, sipas Rregullores së Këshillit Evropian (KE), nr 2494/95, të datës 23 tetor 1995. Inflacioni i Eurozonës matet mbi bazën e treguesit të IHÇK-së. Termi "i harmonizuar", nënvizon faktin që të gjitha vendet e BE-së, zbatojnë të njëjtën metodologji në matjen e treguesit përkatës.*

Në kuadër të konvergjencës, edhe Shqipëria, si një vend kandidat i BE-së, ka detyrim të llogarisë dhe të publikojë treguesin "IHÇK". INSTAT-i, nga muaji shkurt i vitit 2017, ka filluar të publikojë këtë tregues të ri të çmimeve të konsumit, me frekuencë mujore. Objektivi nuk është të disponohen dy matje të ndryshme të inflacionit total, por që secila prej tyre të synojë të llogarisë ecurinë e çmimeve të konsumit në ekonomi, në varësi të qëllimit për të cilat ato ndërtohen, përkatësisht si më poshtë:

- *vlera e inflacionit e llogaritur sipas IÇK-së shërben për të matur ecurinë e çmimeve të konsumit dhe për të hartuar politika dhe strategji ekonomike dhe sociale të vendeve të ndryshme. Më në veçanti, në rastin e Shqipërisë, objektivi parësor i politikës monetare është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në terma numerikë, Banka e Shqipërisë synon, që rritja*

vjetore e çmimeve të konsumit në vend, e matur nga IÇK-ja, të jetë në nivelin 3% në afat të mesëm[III].

- *vlera e inflacionit e llogaritur sipas IHÇK-së, përdoret ekskluzivisht për krahasimin e niveleve të inflacionit, sipas shteteve anëtare dhe kandidate të BE-së.*

Dallimet midis IÇK-së dhe IHÇK-së, në rastin Shqipërisë janë[IV]:

- *Zërat e shportave përkatëse në rastin e Shqipërisë. IÇK-ja përmban 332 zëra; IHÇK-ja përmban 331 zëra (qiraja e imputuar nuk është element i shportës).*
- *Mbulimi i shpenzimeve dhe i burimit të matjes së tyre. IÇK-ja mbulon vetëm shpenzimet familjare private shqiptare të kryera, brenda territorit të vendit. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve (ABF); IHÇK-ja mbulon të gjitha shpenzimet e kryera brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, si dhe shpenzimet e vizitorëve rezidentë dhe jorezidentë. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") janë Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve (HFMCE)".*
- *Struktura e shportave përkatëse. Dallimet më të mëdha ndërmjet dy shportave i përkasin grupeve: "Strehim (qira); "Ujë, lëndë djegëse dhe energji"; "Shëndeti", "Arsim" dhe "Hotele, restorante dhe kafene". Për grupin e parë, dallimi rezulton që në ndërtimin e këtyre indekseve. Në rastin e IÇK-së është përfshirë zëri "Qira e imputuar" me një peshë të rëndësishme, ndërkohë që në ndërtimin e IHÇK-së, ky zë nuk është pjesë e shportës. Në grupet e tjera dallimet janë verifikuar pas kryerjes së dy vrojtimeve që qëndrojnë në bazën e ndërtimit të këtyre dy treguesve, Anketa e Buxhetit të Familjeve 2015 për IÇK-në dhe Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve" për treguesin e dytë.*

Për shkak të ndryshimeve kryesore të përmendura më lart, dy treguesit, jo vetëm nuk mund të japin informacione të njëjta numerike, por mbi të gjitha, nuk mund të përdoren për qëllime të njëjta analizash dhe vendimmarrjeje.

Analizë ndërmjet vlerave të dy treguesve

Krahasimi i dy serive të inflacionit total tregon se ndikimin kryesor në ndryshimet vjetore të IÇK-së dhe të IHÇK-së, në tremujorin e parë të vitit 2017, e ka dhënë grupi "Ushqime dhe pije joalkolike", përkatësisht në masën 75% dhe 83%.

Tabelë 4. Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor për tremujorin e parë 2017 sipas IÇK-së dhe IHÇK-së

Klasifikimi sipas COICOP	Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor IÇK (pp)	Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor IHÇK (pp)
01. Ushqime dhe pije joalkoolike	1.78	3.17
02. Pije alkoolike dhe duhan	0.03	0.03
03. Veshje dhe këpuce	-0.01	0.00
04. Strehim (qira), ujë, lëndë djegëse dhe energji	0.14	0.10
05. Mobilim, pajisje dhe mirëmbajtje shtëpie	-0.01	-0.03
06. Shëndeti	0.01	0.01
07. Transport	0.20	0.22
08. Komunikim	0.00	0.01
09. Argëtim dhe kulturë	0.08	0.07
10. Shërbim arsimor	0.02	0.03

11. Hotele, kafene dhe restorante	0.01	0.01
12. Mallra dhe shërbime të ndryshme	0.15	0.18
Totali	2.38	3.82

Burimi: INSTAT.

Ndryshimet e kontributit nga një tregues në tjetrin lidhen me faktin se kompozimi i peshave të mallrave brenda grupit "Ushqime dhe pije joalkoolike" është i ndryshëm nga një tregues në tjetrin. Kështu, brenda këtij grupi, nëngrupi "Fruta - Perime", ka një peshë më të madhe te shporta e IHÇK-së (12.84% e shportës totale) sesa te ajo e IÇK-së (8.44% e totalit). Për shkak të këtij ndryshimi, kontributi i këtij grupi mallrash te totali është i barabartë me 2.5 pikë përqindje në rastin e treguesit IHÇK dhe me 1.2 pikë përqindje në rastin e IÇK-së. Ndryshime të vogla në kontribute vihen re edhe në disa grupe të tjera, por jo në madhësinë e ndryshimit të rastit të mësipërm. Në përfundim, nëngrupi "Fruta-Perime", ka krijuar 1.3 pikë përqindje ose më shumë se 80% të diferencës së inflacionit të matur sipas dy treguesve (3.84% kundrejt 2.38%).

I *Kjo hapësirë informuese u përgatit nga Gent Hashorva, Departamenti i Politikës Monetare.*

II *Për detaje metodologjike të llogaritjes së IHÇK, referohuni në dokumentin në faqen e internetit të Eurostat: http://ec.europa.eu/eurostat/cache/metadata/en/prc_hicp_esms.htm*

III *https://www.bankofalbania.org/web/Dokumenti_i_Politikes_Monetare_7190_1.php*

IV *Për më shumë detaje referohuni në dokumentin në faqen e internetit të INSTAT: http://www.instat.gov.al/al/themes/%C3%A7mimet/publications/books/2017/indeksi-i-harmonizuar-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit,-mars-2017.aspx*

4.2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Sipas të dhënave të INSTAT-it, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) rezultoi me një rritje reale vjetore prej 4.0% në tremujorin e katërt të vitit 2016. Në terma sektorialë, kontributi kryesor për këtë rritje ka buruar nga sektori i shërbimeve dhe ai i ndërtimit, por ndikime pozitive kanë ardhur edhe nga sektori i industrisë dhe ai bujqësor. Në terma të kërkesës agregate, të gjithë komponentët e saj përbërës, konsumi, privat e publik, investimet dhe eksportet neto kontribuan në rritjen e kësaj periudhe. Kërkesa e brendshme vlerësohet të ketë përfituar nga kushtet monetare lehtësuese, nga përmirësimi i besimit, nga rritja e punësimit dhe nga flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte.

4.2.1. PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE[13]

Të dhënat e vlerës së shtuar sipas aktiviteteve ekonomike tregojnë se rritja e PBB-së në tremujorin e katërt të vitit 2016, vijoi t'i atribuohet kryesisht performancës

[13] *Ecuria e PBB-së dhe e vlerës së shtuar bruto sipas sektorëve trajtohet në terma të ndryshimeve vjetore reale. Analiza mbështetet në të dhënat më të fundit të PBB-së, sipas metodës së prodhimit për tremujorin e katërt të vitit 2016, të publikuara nga INSTAT-i në datën 3 prill të vitit 2017. Diferencat midis normave të rritjes së sektorëve të këtij publikimi dhe atyre të analizuara në Raportin e mëparshëm Tremujor të Politikës Monetare janë rezultat i rishikimit të serive.*

së **sektorit të shërbimeve**. Ashtu si edhe një tremujor më parë, rritja e vlerës së shtuar të shërbimeve u përkthye në një kontribut prej 2.0 pikë përqindjeje për ecurinë vjetore të PBB-së. Kontributi i **sektorit prodhues** u rrit në 1.6 pikë përqindje, nga 0.6 pikë përqindjeje në tremujorin e mëparshëm. Dinamika më e shpejtë rritëse e sektorit prodhues pasqyroi vijimin e ecurisë pozitive të aktivitetit ndërtues dhe përmirësimin e aktivitetit industrial, të cilët kontribuan përkatësisht me 0.9 dhe me 0.6 pikë përqindje në rritjen ekonomike. Ndërkohë, rritja e aktiviteteve të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit dha një kontribut të lehtë pozitiv (+0.1 pikë përqindje) në PBB. Për sa u takon **taksave neto**, kontributi i tyre në PBB vijoi të pakësohet gradualisht, duke rezultuar rreth 0.3 pikë përqindje nga 0.5 dhe 0.4 pikë përqindje në dy tremujorët e mëparshëm[14].

Grafik 20. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. *Të dhënat janë paraprake. **Një vlerësim i parë.

Vlera e shtuar e **sektorit të shërbimeve** vazhdoi të rritet në tremujorin e fundit të vitit (me 4.0%), ndonëse me ritme më të ulëta se gjatë tre tremujorëve të parë (përkatësisht 5.2%, 6.1% dhe 4.3%). Dinamika e sektorit mbetet mbi mesataren historike të rritjes së tij prej 3.1%, me kontribues kryesor degën "Tregti, hotele e restorante dhe transport" (+1.9 pikë përqindje). Kjo degë pasqyroi kryesisht zhvillimet pozitive të aktivitetit tregtar[15].

Dega e *"Administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë"* përshpejtoi ritmet e rritjes vjetore, nga 0.2% në tremujorin e tretë në 2.4% në tremujorin e katërt. Kontributi i saj në vlerën e shtuar të shërbimeve llogaritet rreth 0.6 pikë përqindje. Nga ana tjetër, vlera e shtuar e aktiviteteve të lidhura me "Shërbimet e tjera", "Aktivitetet financiare dhe të sigurimit" dhe "Aktiviteteve

[14] *Komponenti i taksave neto sërish u përcaktua kryesisht nga zëri i taksave mbi produktet, kontributi i të cilit llogaritet rreth 0.3 pikë përqindje për rritjen vjetore të PBB-së.*

[15] *Sipas të dhënave të statistikave afatshkurtra për tremujorin e katërt të vitit 2016, aktiviteti tregtar me shumicë është midis degëve të cilat kanë ndikuar në rritjen e treguesit të shifrës së afarizmit në vëllim për bizneset e shërbimeve.*

profesionale dhe shërbimeve administrative" ngadalësoi rritjen, duke kontribuar me përkatësisht 0.5, 0.4 dhe 0.3 pikë përqindje në rritjen vjetore të sektorit. Dega e "Informacionit dhe komunikacionit" shfaqi një dinamikë pozitive, por kontributi i saj në rritjen e vlerës së shtuar të shërbimeve mbetet i ulët (+0.3 pikë përqindje). Ndërkohë, dega e "Pasurive të paluajtshme" gjeneroi një vlerë të shtuar lehtësisht më të ulët se e njëjta periudhë një vit më parë (rreth 0.2%).

Grafik 21. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Sinjalet e marra nga treguesit e besimit dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në aktivitetet e shërbimeve sugjerojnë për zhvillime pozitive në këtë sektor në tremujorin e parë të vitit 2017.

Grafik 22. Ecuria e vlerës së shtuar në ndërtim dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet e shfaqura nga **sektori ndërtues** mbetën pozitive edhe në tremujorin e katërt të vitit 2016. Megjithatë, dinamika rritëse vjetore e vlerës së shtuar të sektorit prej 6.8%, rezultoi më e ulët se rritja me 8.1% e shënuar një tremujor më parë[16]. Rritja e kategorisë së ndërtimeve të lidhura me punimet inxhinierike[17], vijimi i projektit të ndërtimit të gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) dhe zgjerimi i flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte vlerësohet të kenë ndikuar pozitivisht ecurinë e aktivitetit ndërtues. Treguesit paraprijës të numrit dhe vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit rezultojnë me rritje në të gjitha kategoritë kryesore të ndërtimeve në tremujorin e katërt[18].

Rritja e treguesit të besimit dhe e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim përcjell sinjale pozitive mbi ecurinë e këtij sektori edhe në tremujorin e parë të vitit 2017. Gjithashtu, akordimi i një numri më të madh lejesh ndërtimi, rritja e vlerës së importeve të grupeve të mallrave të lidhura me aktivitetin ndërtues dhe mbështetja nga komponenti publik[19] sugjerojnë vijimin e dinamikës pozitive të sektorit të ndërtimit edhe përtej tremujorit të parë.

Grafik 23. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Performanca e sektorit të industrisë rezultoi pozitive. Kjo u pasqyrua në përmirësimin e ecurisë së vlerës së shtuar të sektorit, e cila shënoi rritje vjetore me 5.1% në tremujorin e katërt të vitit 2016, pas tkurrjes me 3.1% në tremujorin e

16 *Të dhënat e indeksit të vëllimit të prodhimit në ndërtim sinjalizuan këtë ecuri, duke reflektuar një ngadalësim të rritjes së treguesit nga 7.9% në tremujorin e tretë të vitit 2016 në 6.6% në tremujorin në analizë.*

17 *Kategoria e punimeve inxhinierike dha një ndikim pozitiv në ecurinë e indeksit të vëllimit të prodhimit në ndërtim.*

18 *Gjatë tremujorit të katërt, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit rezultoi më e lartë krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, si për ndërtesat për banim, ndërtesat e tjera dhe punimet inxhinierike. Gjithashtu, numri i lejeve të ndërtimit të akorduara ishte 147 nga 145 leje të miratuara një tremujor më parë, dhe ndjeshëm më i lartë se lejet e akorduara një vit më parë.*

19 *Të dhënat paraprake të muajit mars dëshmojnë për rritje të shpenzimeve kapitale të pushtetit qendror në tremujorin e parë të vitit 2017.*

mëparshëm. Zhvillimet pozitive të aktivitetit industrial u përcaktuan nga kontributi në kahun rritës i degës "Industri nxjerrëse, energji, ujë dhe trajtimi i mbetjeve" (+7.9 pikë përqindje). Vlera e shtuar e kësaj dege u zgjerua me 15.6%, një normë mbi mesataren historike të rritjes rreth 7.5%. Përmirësimi i aktivitetit në këtë degë reflektoi, nga njëra anë zgjerimin e prodhimit të energjisë elektrike[20], dhe nga ana tjetër frenimin e kontraktimit të industrisë nxjerrëse[21]. Ndërkohë, dega e "Industrisë përpunuese" u karakterizua nga zhvillime negative, duke kontribuar me rreth -2.7 pikë përqindje në ecurinë e sektorit industrial. Pas ngadalësimit të ritmeve pozitive të rritjes prej tre tremujorësh, vlera e shtuar e industrisë përpunuese shënoi rënie vjetore me 6.0%[22].

Përmirësimi i treguesit të besimit dhe rritja e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve në industri sugjerojnë se dinamika e këtij sektori është pozitive edhe gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Këto sinjale konfirmohen edhe nga zgjerimi i fortë i disa grupeve të eksporteve të produkteve industriale[23] në tremujorin e parë.

4.2.2. KËRKESA AGREGATE

Kërkesa agregate vazhdoi të zgjerohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016, mbështetur si nga kërkesa e brendshme ashtu edhe nga ajo e huaj. Konsumi i popullatës, formimi bruto i kapitalit fiks dhe eksportet neto përbënë kontribuesit kryesorë. Informacionet nga tregues të tërthortë, sugjerojnë të njëjtin profil të rritjes së kërkesës agregate gjatë tremujorit të parë të vitit 2017.

Kërkesa e brendshme u zgjerua me 3.2% në tremujorin e katërt të vitit 2016. Sikurse në tremujorët e kaluar, kontributet kryesore kanë buruar nga konsumi i popullatës dhe formimi i kapitalit. Kontribute të lehta pozitive kanë ardhur edhe nga ana e konsumit publik. Në formimin e kapitalit, vlerësohet që kontributet pozitive janë të lidhura me investimet private.

---

[20] *Të dhënat e indeksit të vëllimit të prodhimit tregojnë për rritje vjetore me 68% të treguesit për degën "Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar" në tremujorin e katërt të vitit 2016. Kjo normë është ndjeshëm më e lartë se rritja mesatare prej 23.4% e shënuar në tre tremujorët e parë të vitit. Gjithashtu, të dhënat e bilancit të energjisë elektrike për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016 dëshmojnë për një rritje të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike me 45.7% krahasuar me një vit më parë, pas rritjes me 8.2% në gjashtëmujorin e parë të vitit.*

[21] *Indeksi i vëllimit të prodhimit për industrinë nxjerrëse vijoi të jetë më i ulët se një vit më parë, rreth 20.3%, por ky ritëm rezulton më i zbutur kundrejt rënies me 39.3% të shënuar në tremujorin e mëparshëm. Gjithashtu, të dhënat e tregtisë me jashtë për këtë industri të orientuar kryesisht nga eksportet regjistrojnë rritje të lartë të eksporteve në vlerë për grupin "Xeherorë, zgjyra dhe hiri", frenim të trendit rënës për grupin "Lëndë djegëse minerale, vajra minerale dhe produkte të distilimit të tyre" dhe vijim të ecurisë rënëse për grupin "Kripëra, sulfure, okside, gëlqere dhe çimento".*

[22] *Eksportet e produkteve të industrive tekstile, të veshjes, të lëkurëve dhe këpucëve, industri me peshën më të lartë në degën e industrisë përpunuese, vazhduan dinamikën pozitive, por në ngadalësim. Kjo sinjalizon një mbështetje në një masë më të vogël të industrisë përpunuese nga këto aktivitete në tremujorin e katërt të vitit 2016.*

[23] *Në tremujorin e parë të këtij viti, eksportet në vlerë për grupet "Xeherorë, zgjyra dhe hiri", "Kripëra, sulfure, okside, gëlqere dhe çimento" dhe "Lëndë djegëse minerale, vajra minerale dhe produkte të distilimit të tyre" regjistruan ritme të larta rritjeje në terma vjetorë.*

Tregues paraprijës dhe të tërthortë sinjalizojnë për vijim të rritjes së kërkesës së brendshme gjatë tremujorit të parë të vitit 2017. Konsumi i popullatës dhe investimet private pritet të vijojnë të mbështesin këtë ecuri. Kontribute pozitive sinjalizohen edhe nga ana e sektorit publik.

Grafik 24. Treguesi i ndjesisë ekonomike dhe struktura e kërkesës së brendshme



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Konsumi privat u rrit me 2.5% në tremujorin e katërt, ritëm ky i njëjtë me mesataren vjetore të tij gjatë vitit 2016. Ky komponent ishte kontribuuesi kryesor i zgjerimit të kërkesës agregate për vitin 2016. Ai u ndikua pozitivisht nga rritja e besimit, kushtet e lehtësuara financiare, rritja e punësimit dhe rritja e të ardhurave të disponueshme. Tregues të tjerë të tërthortë, krahas informacionit nga llogaritë kombëtare, sugjerojnë se rritja e konsumit privat u regjistrua për të tre kategoritë kryesore të tij: mallra konsumi, mallra afatgjata si dhe shërbime[24].

Rritja e konsumit privat vlerësohet të këtë vijuar edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, gjykuar nga të dhënat afatshkurtra të publikuara më shpejt se llogaritë kombëtare. Importi i autoveturave e ai i mallrave ushqimore, dhe tatimi mbi vlerën e shtuar janë zgjeruar në tremujorin e parë. Kredia konsumatore ka vijuar prirjen rritëse dhe treguesit e besimit për sektorët e shërbimeve dhe të tregtisë vijojnë të jenë në një cikël rritës.

Grafik 25. Ecuria e konsumit privat



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[24] *Llogaritë kombëtare tremujore nuk publikojnë rezultate për konsumin e dezagreguar sipas kategorive përbërëse. Tregues të tërthortë mbi të cilët gjykohet për ecurinë e kategorive përbërëse janë rritja e indekseve të tregtisë me pakicë për ushqime dhe për mallra të qëndrueshme, rritja e importit të autoveturave dhe rritja e vlerës së shtuar të sektorit të shërbimeve.*

Grafik 26. Tregues të tërthortë sasiorë (grafiku majtas) dhe cilësorë (grafiku djathtas) për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e parë



*Treguesit monetarë për tremujorin e parë 2017 janë përafruar nga vlerat e muajve janar dhe shkurt 2017.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Investimet u rritën me ritme më të ngadalta në tremujorin e katërt, të ndikuara nga rritja më e ngadaltë si e investimeve në makineri e pajisje, ashtu dhe e investimeve në ndërtim[25]. Rritja me 5.7% e investimeve në këtë tremujor kontribuoi në masën 22% në zgjerimin e kërkesës agregate. Përmirësimi i gjendjes financiare, rritja e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve, rritja e lejeve të ndërtimit, si dhe përmirësimi i besimit të bizneseve në ekonomi mbetën faktorë favorizues për rritjen e investimeve. Burimet e financimit të bizneseve u mbështetën nga rritja e investimeve të huaja direkte dhe nga zgjerimi i kredisë në tremujorin e katërt.

Grafik 27. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore



Burimi: INSTAT.

Tregues të tjerë sasiorë dhe cilësorë nga vrojtimet e besimit sinjalizojnë për vijim të ciklit rritës të investimeve në tremujorin e parë të vitit 2017. Sinjale pozitive vijnë kryesisht nga rritja e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve, përmirësimi i gjendjes financiare të bizneseve dhe rritja e importit të makinerive dhe pajisjeve. Gjithashtu, kredia për qëllime investimi regjistroi ndryshime vjetore pozitive për muajt janar dhe shkurt 2017.

[25] *Gjykuar nga importi i makinerive dhe pajisjeve dhe vlera e shtuar në sektorin e ndërtimit.*

Grafik 28. Tregues afatshkurtër të investimeve për tremujorin e parë



*Kredia për investime për tremujorin e parë të vitit 2017 është përafruar nga rritja vjetore mesatare e muajve janar dhe shkurt 2017.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Ecuria e çmimeve në tregun e banesave[26].

Indekset e çmimit të shitjes dhe të qirasë së banesave kanë shënuar zhvillime me kahe të ndryshme në tremujorin e parë të vitit 2017. Kështu, indeksi i qirasë vijoi prirjen rritëse për të tretin tremujor. Ai u rrit me 6.3% në terma realë vjetorë. Indeksi i çmimit të banesave, pas rritjes me 4% në tremujorin e fundit të vitit 2016, u kthye në normë rënëse në tremujorin e parë të vitit 2017. Ky indeks ra me 5.9% në terma realë. Dinamika e ndryshme e dy indekseve rezultoi në ulje të raportit çmim/qira në tremujorin e parë të vitit 2017[27].

Grafik 29. Indeksi i çmimit dhe i qirasë së banesave* dhe raporti i tyre



*Për të dhënë prirje të treguesve, në grafik paraqiten ndryshimet vjetore të indekseve përkatëse të sheshuara me mesatare lëvizëse.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[26] *Analiza e çmimit dhe e qirasë së banesave bazohet vetëm në informacion mbi çmimet dhe qiratë në qytetin e Tiranës.*

[27] *Ecuria e këtij raporti përmbledh në një tregues të vetëm dinamikën e përgjithshme të çmimit të tregut të banesave dhe përdoret si sinjalizues i "flluskave" të çmimit të banesave.*

Kërkesa e sektorit publik dhe politika fiskale[28]

Plani buxhetor për vitin 2017 sugjeron një pozicion fiskal thuajse neutral, kryesisht në sajë të korrektimit të fortë që njohën financat publike gjatë vitit 2016[29]. Gjatë këtij viti, është planifikuar të arrihet një deficit në masën 2% të PBB-së, nga 1.8% që u vlerësua për vitin 2016. Politika fiskale për vitin 2017, vlerësohet të mbështesë rritjen ekonomike, nëpërmjet instrumenteve afatshkurtra e atyre afatgjata që ajo disponon. Rritja e pritur e konsumit final të qeverisë, e nxitur kryesisht nga rritja e fondit të pagave për punonjësit buxhetorë, si edhe nga shtimi i projektuar i shpenzimeve për investimet publike, vlerësohen të gjenerojnë një kontribut të shtuar në rritjen e kërkesës së brendshme përgjatë vitit 2017.

Natyra e politikës fiskale,[30] e shprehur në terma sasiorë, është faktorizuar në një impuls pozitiv fiskal prej 0.3% të PBB-së deri në fund të tremujorit të parë. Pjesa më e madhe e tij vlerësohet të jetë gjeneruar nga dinamika rritëse e shpenzimeve buxhetore.

Grafik 30. Orientimi i politikës fiskale*



*Grafiku paraqet ndryshimin e deficitit primar të krijuar brenda një viti (shuma rrëshqitëse për 4 tremujorë) në terma të PBB-së nga e njëjta periudhë e një viti më parë. Ndryshimet në kahun pozitiv tregojnë impuls fiskal, ndërkohë që vlerat nën boshtin horizontal sugjerojnë konsolidim të financave publike.
Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të stafit të BSh-së.

Në tremujorin e parë të vitit, shpenzimet buxhetore kanë vijuar tendencën rritëse të nisur që prej tremujorit të tretë të vitit të mëparshëm. Për tre muajt e parë të vitit ato u realizuan me 91.9 miliardë lekë, nivel ky rreth 10.3% më i lartë në terma vjetorë nominalë. Shpenzimet për pushtetin lokal, ndryshe nga sjellja historike, vijojnë të udhëheqin rritjen e totalit të shpenzimeve[31]prej tre

[28] *Të dhënat fiskale paraprake për 3-mujorin i përkasin publikimit të Ministrisë së Financave të datës 20 prill 2017.*

[29] *Konsolidimi fiskal në vitin 2016 rezultoi më i lartë nga planifikimi.*

[30] *Kahu dhe natyra e politikës fiskale analizohen duke marrë në konsideratë një vit të plotë kalendarik.*

[31] *Rastet e tjera ku shpenzimet për pushtetin lokal kanë formuar në një masë të madhe rritjen e totalit të shpenzimeve janë sporadike dhe jo të qëndrueshme në kohë.*

tremujorësh. Gjatë tremujorit të parë, rritja e këtij zëri përfaqësoi rreth 37% të rritjes së totalit të shpenzimeve. Zërat e tjerë që kanë mbështetur rritjen e shpenzimeve gjatë këtij tremujori ishin shpenzimet për sigurimet sociale dhe ato kapitale, përkatësisht me 5.5 dhe 2.6 pikë përqindje. Në kahun e kundërt kanë ndikuar shpenzimet për interesat e borxhit, të cilat amortizuan pjesërisht rritjen e totalit të shpenzimeve (-1.8 pikë përqindje).

Grafik 31. Ecuria e shpenzimeve



Burimi: Ministria e Financave.

Zhvillimet në zërat e shpenzimeve sugjerojnë që konsumi final i qeverisë, si edhe formimi bruto i kapitalit fiks publik pritet të ndikojnë pozitivisht rritjen e kërkesës agregate në tremujorin e parë të vitit 2017.

Të ardhurat për tre muajt e parë të vitit u realizuan me rreth 100.8 miliardë lekë, ose rreth 4.3% më lart se e njëjta periudhë e një viti më parë. Zërat kryesorë

Grafik 32. Ecuria e të ardhurave buxhetore



Burimi: Ministria e Financave.

tatimorë që formuan rritjen e totalit ishin të ardhurat nga pushteti lokal[32], TVSh-ja, sigurimet sociale dhe taksat kombëtare. Në të kundërt, të ardhurat me karakter jotatimor si edhe grantet, kanë dhënë kontribut negativ në rritjen e totalit të të ardhurave, me rreth 2.3 pikë përqindje.

Dinamika e zërave specifikë të të ardhurave jep sinjale pozitive për ecurinë e konsumit, si edhe sugjeron kushte të përmirësuara në tregun e punës gjatë tremujorit të parë të vitit 2017.

Në tremujorin e parë të vitit, balanca buxhetore rezultoi pozitive rreth 8.9 miliardë lekë, ose 33.2% më e ulët së e njëjta periudhë e një viti më parë. Pavarësisht këtyre vlerave pozitive, huamarrja e qeverisë ka vijuar të rritet si në tregun e brendshëm (11.2 miliardë lekë), ashtu edhe në atë të huaj (rreth 8.7 miliardë lekë), duke rezultuar në nivele të larta likuiditeti të qeverisë.

Grafik 33. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e huaj dhe tregtia e jashtme

Deficiti tregtar në mallra dhe shërbime në tremujorin e katërt 2016 u ngushtua rreth 21.7% në terma realë. Përcaktuesi kryesor në këtë zhvillim ka qenë rritja vjetore e eksportit të shërbimeve me 12.9%. Gjithashtu, edhe eksporti i mallrave shënoi një rritje të lartë vjetore (25.9%), duke përmbysur dinamikën negative që karakterizoi tremujorët e kaluar. Nga ana tjetër, importet u pakësuan me 0.5%, të ndikuara kryesisht nga rënia e importit të mallrave (-0.4%). Gjithashtu, importet e shërbimeve janë pakësuar me 0.6% në terma realë vjetorë.

Grafik 34. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë)



Burimi: INSTAT.

[32] *Të ardhurat nga pushteti lokal vijojnë të mbështesin në mënyrë të qëndrueshme rritjen e të ardhurave totale për katër tremujorë me radhë.*

Të dhënat mbi ecurinë e eksporteve dhe të importeve të mallrave për vitin 2017, përfshijnë statistikat për tremujorin e parë. Deficiti tregtar në mallra u zgjerua me rreth 1.3% në terma vjetorë, i ndikuar kryesisht nga rritja e importeve.

Eksporti i mallrave në vlerë u zgjerua me rreth 15.7% në nivel vjetor gjatë tremujorit të parë të vitit 2017. Kontributi kryesor në këtë ecuri ka ardhur nga rritja e eksportit të kategorive "Materiale ndërtimi dhe metale", "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" dhe "Tekstile dhe këpucë".

Në kategorinë e parë, rritja e eksporteve është orientuar si drejt partnerit kryesor, Italisë, ashtu edhe në drejtim të disa vendeve fqinje (Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Greqi dhe Bullgari), të cilat përgjithësisht kanë pasur pesha të ulëta. Eksportet janë rritur edhe në drejtim të partnerëve të tjerë më të largët, duke zgjeruar tërësinë e vendeve ku eksportohen këto produkte. Duke pasur parasysh që këto janë zhvillime të reja për këtë kategori (të përqendruara kryesisht në muajin mars 2017), nuk është ende e qartë nëse janë të përkohshme apo përbëjnë një gjendje me natyrë afatgjatë.

